

KUSHTET E PUNËS DHE KRITERET E PUNËSIMIT

Përditësimi i fundit 11 Mars 2025

Kohëzgjatja normale e javës së punës në Republikën e Shqipërisë është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës (neni 83 KP). Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë (pika 1, neni 78 KP). Për punëmarrësit nën 18 vjeç kohëzgjatja ditore e punës është jo më shumë se 6 orë në ditë (pika 3 , neni 78).

Këshilli i Ministrave përcakton kohëzgjatjen javore të reduktuar për punët që paraqesin vështirësi ose që janë të dëmshme për shëndetin (neni 84, KP).

Si rregull ndalohet puna në ditët e festave zyrtare. Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare. Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë. Përjashtimet për të punuar në ditët e festave zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive (neni 86, KP).

Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare. Kur dita e festës zyrtare bie ditën e pushimit javor, atëherë pushimi shtyhet për ditën pasardhëse të punës. Mënyra dhe masa e kompensimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kontratë kolektive ose kontratë individuale (neni 87, KP).

Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës (neni 92, paragrafi 1 i KP).

Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 22 ditë pune gjatë vitit të punës në vazhdim. Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet (neni 92, paragrafi 2 i KP).

Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paafëtisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune (neni 92, paragrafi 3 KP).

Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80 për qind të pagës për një periudhë prej 14 ditësh të pambuluara nga sigurimet shoqërore (neni 130, paragrafi 1 i KP).